




Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	17. 11 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBICK	5507/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.831/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti -anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.831/2021 të datës 23.09.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Ulpiana E31, UH1, Nr.1, Komuna e Prishtinës, kundër Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “Kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.831/2021 të datës 23.09.2021, të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas kontratës të datës 27.11.2018 i punësuar në Muzeun e Kosovës, me datë 18.06.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me pretendimet se të njëjtit i është zbritur koeficienti pa procedura të rregullta me kërkesën për kompensim financiar.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me datë 30.08.2021 ka nxjerr vendimin me numër KZKA Nr.01/2021 duke ia aprovuar pjesërisht ankesën e datës 18.06.2021.

Ankuesi i pakënaqur me pikën 2 (dy) “Ndryshimi i pozitës nga Shërbyes Civil në pozitën Zyrtar i Lartë për Trashëgimi Shpirtërore në krijues dhe Përformues Kustos nuk ka bazë ligjore” të Vendimit KZKA Nr.01/2021 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të datës 30.08.2021, sipas udhëzimit në mjete juridike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.09.2021 dhe numër prot:4766/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.09.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te ankuesit tek Ministria

e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli me datë 07.10.2021 ka pranua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përgjigjen në kërkesë me numër protokollit: 4928/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.11.2021 ka marr vendimin numr:40/2021 për shtyrjen e afatit për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune, ndërsa në bazë të fletëkthesës ankuesi vendimin e njëjtë e ka pranuar me datë 12.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4766/2021 të datës 23.09.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KZKA Nr.01/2021 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 30.08.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.06.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 07.10.2021; Kontratën e punës së ankuesit të datës 27.11.2018; Konfirmimin e Udhëheqësit e Divizionit të Burimeve Njerëzore të datës 06.10.2021; Ankesën e ankuesit të datës 18.06.2021 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.831/2021 të datës 23.09.2021, të parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të kontratës së punës të datës 27.11.2021 ka themeluar marrëdhënien e punës në Muzeun e Kosovës, dhe i njëjti mban pozitën "Kustos".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar katalogun e vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me vendimin numër Nr.9 të datës 21.02.2018, dhe me këtë rast pozita "Kustos" që mban ankuesi nuk është pozitë në Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht në bazë të kontratës së punës së ankuesit të datës 27.11.2021 Kolegji ka gjetur se i njëjti marrëdhënien e punës e ka themeluar duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, andaj mbi bazën e kësaj meqenëse ankuesi marrëdhënien e punës nuk e ka themeluar siç parashihet në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/10 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil Kolegji konstaton se ankuesi nuk e ka pasur statusin e Nëpunësit Civil as para se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik t'i caktoj statusin e ri siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, madje statusin e Nëpunësit Civil nuk ka fituar as pas vendosjes nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik .

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të Konfirmimit të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të datës 06.10.2021 ka konstatuar se ankuesit Departamenti për menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i ka caktuar statusin, nëpunës i Shërbimit Publik të Kosovës, e që sipas nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 të të njëjtit Ligj përcaktohet se: "1.Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit; 2. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente", nga rrjedh se këshilla juridike sipas vendimit KZKA Nr.01/2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të datës 30.08.2021 i është dhënë gabimisht dhe në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore.

Bazuar nënin 6 paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat për nëpunësit e Shërbimit Civil dhe kandidatëve që konkurrojnë për pranim në Shërbimin Civil, të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, pas konstatimit se pozita



“kustos” të cilën e ushtron ankuesi si dhe në bazë të kontratës së tij të punës të datës 27.11.2018 është konstatuar se ankuesi asnjëherë nuk e ka pasur statusin e nëpunësit civil, dhe i njëjti statusin e nëpunësit civil nuk e ka fituar as pasi që ka vendosur Departamenti për Menaxhimin e Zyrtare e Publik kur edhe është njoftuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve sipas Konfirmimit të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të datës 06.10.2021, Këshilli konstaton se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit meqenëse i njëjti nuk e ka statusin e nëpunësit të Shërbimit Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.831/2021

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;